




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 260/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z.Goran Milenković– Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina-Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “NTP Mali-I & NTP Vlora” kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku i rekomanduar për dhënie të kontratës nga ana e AK-se është OE EOR GROUP” SH.PK. të Vendimit të AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull të prokurimit: “Furnizim me pajisje muzikore për fakultetin e arteve, Universiteti Haxhi Zeka-Pejë” me numër të prokurimit: 612-19-1816-1-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) “Universiteti Haxhi Zeka”-Pejë” më datën 20.06.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “NTP Mali-I & NTP Vlora” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje muzikore për fakultetin e arteve, Universiteti Haxhi Zeka-Pejë” me numër të prokurimit: 612-19-1816-1-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues AK- “Universiteti Haxhi Zeka”-Pejë

II. ANULOHET, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Furnizim me pajisje muzikore për fakultetin e arteve, Universiteti Haxhi Zeka-Pejë” me numër të prokurimit: 612-19-1816-1-2-1 AK- “Universiteti Haxhi Zeka”-Pejë” dhe lënda kthehet në Ri vlerësim.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues“NTP Mali-I & NTP Vlora” aprovohet si pjeserisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:08.04.2019

Data e hapja së ofertave:26.04.2019

Data e njoftimit me letër standarde për tenderuesit te pasuksesshëm: 13.05.2019

Kundër njoftimit te autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik“DPT Genc”-Mitrovicë me dt: 17.05.2019, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Autoriteti Kontraktues- “Universiteti Haxhi Zeka”-Pejë” me datën 20.05.2019 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE: “NTP Mali-I & NTP Vlora” si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues “NTP Mali-I & NTP Vlora” si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 29.05.2019 me nr. 260/19, kundër vendimit te AK, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull“Furnizim me pajisje muzikore për fakultetin e arteve,Universiteti Haxhi Zeka-Pejë” me numër të prokurimit: 612-19-1816-1-2-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) -“Universiteti Haxhi Zeka”-Pejë” duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,6,7,59,60 ,si dhe neni 72të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 31.05.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues profesional në raportin e dt:07.06.2019,lidhur me pretendimin ankimore te OE ankues

“NTP Mali-I & NTP Vlora” në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të këtij aktiviteti të prokurimit, konstaton si në vijim:

Lidhur me pretendimin e grupit OE ankues NTP “Mali-i” dhe NTP “Vlora” se AK gjatë vlerësimit të ofertave ka eliminuar ofertën e grupit të OE të lartë cekur edhe pse si ofertë me e lirë me arsyetimin se nuk kane paraqitur dëshmi për projekte të ngjashme të realizuara në tri vitet e fundi me ç ‘rast AK ka bërë shkelje të LPP-se, përkatësisht Nenin 1 Qëllimin, Nenin 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, Nenin 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminim, Nenin Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i tenderëve, Nenin 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës, Nenin 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë dhe nenin 39 të UOPP-Sqarimi i tenderëve, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit të ofertave nuk ka zbatuar në tërësi LPP, konkretisht nenin 72-Dokumentacioni dhe informata shtesë. AK sipas këtij neni është i obliguar të kërkojë sqarime apo informata shtesë për të plotësuar apo qartësuar, duke konsideruar që dokumentet e kërkuara nga AK janë dokumente, ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para afatit për dorëzimin e tenderëve dhe verifikohen në mënyrë objektive. Gjithashtu sipas nenit 39 të UOPP-Sqarimi i tenderëve, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkojë dhe të marrë informacion apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë se kane ekzistuar para afatit të fundit të dorëzimit të aplikacionit apo të dorëzimit të tenderit. Përveç kësaj, kërkesa nuk do të duhej që të favorizojë apo dëmtoj padrejtësisht ofertuesin përkatës.

Grupi i OE NTP “Mali-i” dhe NTP “Vlora” në ofertën e tyre të dërguar përmes platformës e-prokurimi kanë paraqitur një listë të kontratave për projekte të ngjashme pa ofruar dëshmitë apo referencat e realizimit të këtyre kontratave. Konsiderojmë që AK para vendimit për eliminimin e ofertës së grupit OE ankues NTP “Mali-i” dhe NTP “Vlora” (si ofertë më e lirë) është dashur të kërkojë informata shtesë nga ky grup i OE në mënyrë që të vërtetohet se ai disponon këto dëshmi/referenca për realizimin e këtyre projekteve/kontratave (neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë dhe nenin 39 të UOPP-Sqarimi i tenderëve).

Në kërkesën për rishqyrtim të bërë nga Grupi i OE NTP “Mali-i” dhe NTP “Vlora” të datës 17.05.2019, në deklaratën mbi faktet dhe argumentet nga ky konzorcium është potencuar se dëshmitë për referenca për kontratat e realizuara i disponon, duke cekur edhe kontratat me numër të paraqitur në listën e kontratave në oferte dhe shumat e kontratave, pavarësisht kësaj AK me vendim të datës 20.05.2019 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të grupit të OE NTP “Mali-i” dhe NTP “Vlora” me arsyetimin se mungojnë dëshmitë e referencave apo procesverbali i pranimit të punëve pa kërkuar nga parashtruesi i kërkesës për rishqyrtim që ti

sjell dëshmitë e kërkuara sipas Dosjes së tenderit 9.1 dhe 9.2. Konsiderojmë që me këtë rast AK ka bërë shkelje të nenit 6,7,59,60,72 dhe nenit 39 të UOPP-së. Konstatojmë se pretendimi ankimor është i bazuar

Në bazë të sqarimeve të lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e grupit të OE ankues të pranohet për arsyen që i theksuam në përgjigjeje të pretendimit ankimor të më sipërm. Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së rekomandon autoritetin kontraktues që ta kthejë në RIVLERËSIM aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje muzikore për fakultetin e arteve, Universiteti Haxhi Zeka-Pejë” me nr.prokurimi 612-19-1816-1-2-1 të iniciuar nga AK-“Universiteti Haxhi Zeka-Pejë”

Operatori Ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datës:10.06.2019 ka njoftuar Panelin shqyrtues sepajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 10.06.2019 ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 20.06.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtuesi, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, ku shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seance përfaqësuesi i OE-ankues ankues z. Krasniqi deklaroj: Konzorciumi N.P.T.”MALI-I” & N.T.P.”VLORA” pajtohet plotësisht me konstatimet ligjore të Eksperti shqyrtues duke e konsideruar raportin e ekspertizës objektiv, profesional dhe ligjor.

AK- Universiteti “Haxhi Zeka” gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka respektuar nenin 1, 6, 7, 59, 60, 72 të LPP-së dhe nenin 39 të UOPP-së. Autoriteti Kontraktues padrejtësisht ka eliminuar kompaninë tërë nga ky projekt edhe pse në kemi plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit. AK gjatë vlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka kërkuar sqarime nga kompania-konzorciumi edhe pse lista e kontratave të dorëzuara tejkalon minimumin e kërkesës nga Autoriteti Kontraktues të paraqitur në nenin 9.1&9.2 të FDT-se lidhur me kapacitetin teknik dhe/ose profesional. Siç ka cekur dhe eksperti shqyrtues në ekspertizë Autoriteti Kontraktues ka pas mundësinë që pas parashtërimit të kërkesës për ri-shqyrtim nga kompania jone të kërkojë sqarime shtese

dëshmitë mbi realizimin e kontratave ne liste mirëpo nuk ka mare parasysh kërkesën tone përkundër argumenteve dhe pretendimeve ligjore te parashtruara ne ankese.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Fetaj deklaroi: Ne nuk e kemi marr ne shqyrtim për bazë Konzorciumin një nder ka qene s'ka pas referenca qe janë kërkuar ne DT, e ka sjell një referencë te konzorciumit ne vlere 3.900 euro referenca te tjera nuk ka sjellë, Kompania mali Lideri i konsorciumi veprimtarin punuese e ka përpunim te drurit ndërtesa, tregti me shumice por jo pajisje muzikore siç kërkohen ne DT . Konzorciumi e ka shkel edhe nenin 71 te LPP-së te gjitha marrëveshjet e liferimit i ka shkelur. Konzorciumi nuk i plotëson kërkesat e DT-së.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Papaj deklaroi: Unë nuk po lëshohem gjate se ka edhe pretendime te tjera mirëpo detyra ime ka qen vetëm te jap përgjigje qe ka dhen OE ankues Arsyeja e refuzimit te Konzorciumit është se nuk kanë sjelle dëshmitë e referencave apo procesverbali i përfundimit te punëve, ne oferte është e paraqitur një listë e kontratave ku përshkruhen llojet e furnizimeve, sipas ekspertizës sime është dashur bazuar ne nenin 72 te LPP-së te kërkohen indo shtese se këto referenca a i disponon grupi i Konzorciumit, pavarësisht se OE ka bere kërkesë për rishqyrtim mirëpo është refuzuar nga Autoriteti Kontraktues me arsyetimin se nuk ethe par e arsyeshme te zbatohet neni 72 i LPP-së . Ne disa raste e zbatojnë nenin 72 e ne disa nuk e zbatojnë nenin 72 te LPP-së. Unë kam kërkuar te kthehet ne rivlerësim ai shpallet i papërgjegjshëm listat e kontratave i ka. Është përgjegjësi qe buxhetin Rep. Kosovës ta shfrytëzojnë ne mënyrë sa me te mire.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroi: Kërkojmë nga paneli shqyrtues qe te aprovoje ankesën e konzorciumit N.P.T. "MALI-I" & N.T.P. "VLORA" si te bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroi: propozojmë qe ankesa e OE ankues te refuzohet si e pabazuar dhe te mbetet ne fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues profesional , deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, lidhur me pretendimin e grupit OE ankues NTP "Mali-i" dhe NTP "Vlora" se AK gjatë vlerësimit të ofertave ka eliminuar ofertën e grupit te OE të lartë cekur edhe pse si ofertë me e lirë me arsyetimin se nuk kane paraqitur dëshmi për projekte te ngjashme të realizuara në tri vitet e fundi me ç 'rast AK ka bërë shkelje të

LPP-se, përkatësisht Nenin 1 Qëllimin, Nenin 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, Nenin 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminim, Nenin Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i tenderëve ,Nenin 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës, Nenin 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë dhe nenin 39 të UOPP-Sqarimi i tenderëve,paneli shqyrtues konform ekspertiti shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit të ofertave nuk ka zbatuar ne tersi LPP, konkretisht nenin 72-Dokumentacioni dhe informata shtesë. AK sipas këtij neni është i obliguar të kërkoj sqarime apo informata shtesë për të plotësuar apo qartësuar, duke konsideruar qe dokumentet e kërkuara nga AK janë dokumente, ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para afatit për dorëzimin e tenderëve dhe verifikohen në mënyre objektive. Gjithashtu sipas nenit 39 të UOPP-Sqarimi i tenderëve, lejohet qe një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacion apo dokumente, te cilat mungojnë ne aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, ne mënyre objektive duhet të prezantojnë se kane ekzistuar para afatit te fundit te dorëzimit te aplikacionit apo te dorëzimit të tenderit. Për veç kësaj, kërkesa nuk do te duhej qe të favorizojë apo dëmtoj padrejtësisht ofertuesin përkatës.

Paneli shqyrtues konform ekspertiti shqyrtues konstaton se OE Grupi i OE NTP “Mali-i” dhe NTP “Vlora” në ofertën e tyre të dërguar përmes platformës e-prokurimi kanë paraqitur një listë të kontratave për projekte të ngjashme pa ofruar dëshmitë apo referencat e realizimit të këtyre kontratave. Konsiderojmë që AK para vendimit për eliminimin e ofertës së grupit OE ankues NTP “Mali-i” dhe NTP “Vlora”(si ofertë më e lirë)është dashur të kërkoj informata shtesë nga ky grup i OE në mënyrë që të vërtetohet se ai disponon këto dëshmi/referenca për realizimin e këtyre projekteve/kontratave (neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë dhe nenin 39 të UOPP-Sqarimi i tenderëve).

Paneli shqyrtues konsform ekspertit shqyrtues sqaron se sqaron se në kërkesën për rishqyrtim të bërë nga Grupi i OE NTP “Mali-i” dhe NTP “Vlora” të datës 17.05.2019, në deklaratën mbi faktet dhe argumentet nga ky konzorcium është potencuar se dëshmitë për referenca për kontratat e realizuara i disponon, duke cekur edhe kontratat me numër të paraqitur në listën e kontratave në oferte dhe shumat e kontratave, pavarësisht kësaj AK me vendim të datës 20.05.2019 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të grupit të OE NTP “Mali-i” dhe NTP “Vlora” me arsyetimin se mungojnë dëshmitë e referencave apo procesverbali i pranimit të punëve pa kërkuar nga parashtruesi i kërkesës për rishqyrtim që ti sjell dëshmitë e kërkuara sipas Dosjes së tenderit 9.1 dhe 9.2. , andaj paneli shqyrtues konstaton se me këtë rast AK ka bërë shkelje të nenit 6,7,59,60,72 dhe nenit 39 të UOPP-së. Konstatojmë se pretendimi ankimor është i bazuar.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahاسimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK –“Universiteti Haxhi Zeka”-Pejë”
- 1x1 OE-“NTP Mali-I & NTP Vlora”
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković

